

KOZETA HYSO

**ANTROPONIMET E HUAJA DHE PROBLEMET E PËRKTHIMIT
TË TYRE NË GJUHËN SHQIPE**

Hyrje

Shumëkujt nga ata që nuk e kanë humbur ndjesinë e gjuhës shqipe, u vjen keq kur shohin titujt e gazetave, revistave, madje edhe teksteve shkollore të mbushura me gabime drejtshkrimore, që kanë të bëjnë me emrat e përveçëm të huaj, kryesisht anglezë. Në një vëzhgim që kemi bërë në disa prej teksteve shkollore të leximit letrar e të letërsisë shqipe, kemi zbuluar shumë raste të shtrembërimit drejtshkrimor të emrave, të autorëve të huaj. Vihet re se emrat e disa autorëve të vjetër, për drejtshkrimin e të cilëve tashmë është krijuar një traditë, në botimet e disa shtëpive botuese private, ka shkelje e shtrembërime drejtshkrimore, siç i shkruan njëra nuk i shkruan tjetra, pra nuk po zbatohet parimi fonetik në shkrimin e emrave të përveçëm të huaj. Ky artikull ka për qëllim të sensibilizojë të gjithë autorët e botuesit e teksteve shkollore për përdorimin e një gjuhe letrare sa më të saktë dhe brenda rregullave drejtshkrimore.

Në vitin 1967 u botua libri “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” (projekt). Dalja e këtij projekti shënoi një sukses në hapat e para të përpjekjeve për njësimin e gjuhës shqipe. Këto rregulla u cilësuan si kodifikimi më i plotë e më sistematik i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Gjithashtu ato u cilësuan si ndihmesë për kristalizimin përfundimtar të gjuhës së sotme letrare kombëtare. Diskutimi i këtij projekti zgjati për një periudhë relativisht të gjatë.

Në nëntor 1972 u mbledh Kongresi i Drejtshkrimit, i cili shënoi një ngjarje të rëndësishme historike për gjuhësinë shqiptare, për kulturën dhe kombin shqiptar. Ai u quajt “Kongresi i Drejtshkrimit”, sepse gjithë vëmendjen ia kushtoi njësimin të drejtshkrimit, si hapi i parë që shpie drejt normës letrare standarde.

Aty u pat parasysh, që në rregullat e drejtshkrimit të kombinohej drejt parimi fonetik me atë morfologjik e historik. Ky kongres pati rëndësi të veçantë sepse ai zgjidhi përfundimisht problemin e standardizimit të shqipes letrare. Kongresi i Drejtshkrimit, nëpërmjet njësimin të normës drejtshkrimore, mbështeste gjuhën letrare të njësuar, duke i dhënë kësaj një formë të vetme e të përbashkët për gjithë kombin shqiptar.

Kështu, Kongresi veproi sipas parimit “një drejtshkrim i njësuar, i vetëm për një gjuhë letrare të njësuar e të njëjtë për të gjithë shqiptarët”.

Në vetë “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”, si dhe në punimet e Kongresit, u diskutua për shumë çështje të normës gramatikore. U vunë në dukje edhe disa të meta të Projektit, si dhe u ngritën probleme me interes, një ndër të cilët ishte edhe drejtshkrimi i emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe. Për rregullat se si duheshin shkruar këta emra pati dy qëndrime.

Qëndrimin të parë i përkisnin ata që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhej të shkruheshin sipas traditës vendase duke zbatuar drejtshkrimin e shqipes, sipas shqiptimit që kanë emrat e huaj në gjuhën prej nga merren.

Qëndrimi i dytë u përkiste atyre që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhej të shkruheshin sipas grafisë në gjuhën dhënëse.

2. Mendimet pro dhe kundër parimit fonetik në shkrimin e emrave të huaj

Para dhe pas Kongresit ishte shprehur mendimi se: “kur është fjala për emrat e përveçëm të njerëzve shqip, emrat e njerëzve s’kanë të bëjnë fare me rregullat drejtshkrimore, secili person ka të drejtë të shkruajë e të fiksojë emrin e vet ashtu siç i pëlqen e siç i vjen më mbarë atij.”¹

Kishte dhe disa të tjerë që mendonin se emrat e njerëzve, në mos tërësisht, në pjesën më të madhe mund dhe duhet të kenë një sistem të caktuar drejtshkrimor. Palok Daka dhe përkrahësit e mendimit të tij, gjithashtu mendonin se: “Meqë emrat e njerëzve përsëriten me mijra herë nëpër akte, regjistra, dokumente, indekse alfabetike, duhet të ketë një rregull të caktuar për shkrimin e tyre, sepse nga shkrimi i saktë apo i gabuar i tyre varen, shpeshherë lehtësitë apo vështirësitë e veprimeve që lidhen me personat bartës të tyre.”²

Ata arsyetonin se, si fjalët ashtu edhe emrat e njerëzve, janë pasuri e përbashkët e gjuhës së popullit që i flet, por dallojnë nga njëri-tjetri në fushën e përdorimit dhe të funksionit të tyre. Ata gjithashtu mendonin se fjalët, si njësi kuptimore të gjuhës, të formuara historikisht kanë karakter shoqëror-kolektiv, ndërsa emrat e njerëzve si njësi që nuk kanë kuptim leksikor por thjesht emërojnë, kanë karakter shoqëror-individual. Pra, kjo do të thotë, se fjalët nuk mund të krijohen e as të zëvendësohen arbitrarisht me të tjera pa pëlqimin e kolektivit që i përdor. Emrat mund të krijohen ose dhe të zëvendësohen në rrethana të caktuara, arbitrarisht edhe nga individë të ndryshëm.

Emrat e njerëzve gjatë përdorimit të tyre të shpeshtë në të shkruar e në të folur, nga njëra krahinë në tjetrën na shfaqen grafikisht e fonetikisht më pak të qëndrueshëm dhe, për pasojë, më të ndjeshëm ndaj luhatjeve dhe shtrembërimeve, se sa njësitë e tjera leksikore të gjuhës. Për këtë arsye, problemi i drejtshkrimit të emrave të përveçëm të huaj të dukej mjaft i ndërlikuar dhe ia vlente të diskutoj me kujdes.

Si përfundim, Kongresi vendosi: “Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Me përjashtim të rr-së, bashkëtingëllore dyfishe të këtyre emrave nuk ruhen në shkrim në gjuhën shqipe. Në shfaqen e parë

¹ P. Daka, *Mbi drejtshkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve në gjuhën shqipe*, Kongresi i Drejtshkrimit, f. 235.

² P. Daka, *Mbi drejtshkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve në gjuhën shqipe*, Kongresi i Drejtshkrimit, f. 235.

Antroponimet e huaja dhe problemet e përkthimit të tyre në gjuhën shqipe

*të kësaj kategorie mund të shënohet në kllapa edhe shkrimi i tij sipas ortografisë vendase”.*³

Unifikimi i rregullave të drejtshkrimit pati një rëndësi të veçantë për kohën. Gjatë kësaj periudhe kemi një bum përkthimesh të veprave të shumta të autorëve të huaj, po kështu edhe të shumë autorëve anglezë e amerikanë me famë botërore.

Ishte koha kur gjuhët e huaja njiheshin nga një pjesë e vogël e popullsisë. Letërsia e përkthyer duhej t’u drejtohej të gjithëve, edhe atyre që ishin më pak të shkolluar. Për këtë kategori të popullsisë nuk do të ishte e vështirë të mësonin emrat e autorëve të huaj, sepse, në bazë të rregullave të drejtshkrimit, emrat e këtyre autorëve do të shkruheshin fonetikisht, d.m.th. sipas shqiptimit në gjuhën origjinale por duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe. E gjithë shoqëria ishte e interesuar për ngulitjen e normës së njësuar dhe zbatimin e saj.

3. Shqipja standarde përballë procesit të globalizimit

Shqipëria e viteve ’90 pësoi ndryshime rrënjësore në sistemin politik, ekonomik, social e kulturor. Është periudha kur Shqipëria përballlet me kërkesa e probleme të reja. Në të gjitha fushat e jetës filloi të punohej për integrimin e vendit në Evropë. Përballemi me një fenomen të ri, fenomenin e globalizmit, por procesi i globalizmit duhet kuptuar si një përpjekje për ta ruajtur gjuhën nga asimilimi dhe për ta rreshtuar atë me dinjitet krahas gjuhëve të tjera evropiane. Ne jemi pjesë e familjes evropiane, por të jesh pjesë e përpjekjeve të kësaj familje të madhe evropiane nuk do të thotë të harrosh vetveten, apo t’i nënshtrohesh një gjuhe tjetër. Në këtë bashkësi qytetërimesh ne duhet të futemi në radhë të parë me identitetin tonë kulturor e kombëtar. Gjuha është pjesë e këtij identiteti, e mbijetesës sonë si komb.

Pas viteve ’90 në gjuhën shqipe kemi vërshimin e shumë fjalëve anglisht, duke përfshirë këtu edhe emrat e përveçëm. Këto hyjnë kryesisht nga gjuha e shkrimit, si përkthimet politike, letrare, ekonomike, nga gazetatat, gjuha e folur e televizioneve, radiove, intervistave e konferencave të shtypit, etj. Si pasojë vihet re një shmangie e shkelje gjuhësore në të gjitha rrafshet, p.sh. në rrafshin e shqiptimit, të leksikut, të morfologjisë, të sintaksës, e kryesisht të drejtshkrimit, ku drejtshkrimi e drejtshqiptimi i emrave të përveçëm duhet marrë si një çështje më vete jo pak i rëndësishëm.

Ruajtja e grafisë së huaj po karakterizon vitet e fundit shkrimit e emrave të përveçëm të huaj të njerëzve e të vendeve, veçanërisht ata të përdorur rishtas, por edhe të tjerë me traditë përdorimi më të hershëm në shqipe. Po vihet re një praktikë e re e cila është në kundërvënje të plotë me zgjidhjen standarde në shqipe, e cila i përmbahet parimit fonetik të të shkruarit. Disa e justifikojnë këtë praktikë të re me faktin se numri i këtyre emrave të huaj që po hyjnë në gjuhën shqipe është aq i madh, saqë është e vështirë që të mësosh shqiptimin e tyre dhe pastaj t’i shkruash ato duke zbatuar grafinë e gjuhës shqipe aq më tepër sot kur përballemi me epokën e superzhvillimit të teknologjisë së informacionit, të kontakteve pa

³ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1973*, § 37, f. 104.

fund të gjuhëve e të kulturave, jo vetëm përmes shkrimit, por edhe përmes takimeve të drejtpërdrejta, si rezultat i lëvizjes së lirë të njerëzve, të ekspansionit të anglishtes dhe të shndërrimit të saj në “gjuhë globale”.

4. Shkelje e normës drejtshkrimore në botimet shkollore

Si rrjedhojë e ndikimit të “gjuhës globale” vihen re shumë shkelje e deformime gjuhësore edhe në tekstet shkollore. Vihen re shkelje të rregullave të drejtshkrimit të emrave të përveçëm anglo-saksonë e amerikanë. Më të theksuara janë këto shkelje në drejtshkrimin e toponimeve. Po sjellim disa raste:

Letërsia 4 (për shkollat e mesme), faqe 181. “**Xhejms Xhois**” (sipas shqiptimit duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe). Po aty lexojmë:

“... Në vitin 1888 prindërit e regjistrojnë në **Clongowes Wood College** ...

... Më 1898 **Xhojsi** regjistrohet në **University College** ...” (thyerje e normës drejtshkrimore).

Letërsia 2 (për shkollat e mesme të përgjithshme, botim i vitit 2006), faqe 330 lexojmë: “**William Shekspir**”. Po aty lexojmë:

“**Shekspiri** lindi më 23 prill 1564 në **Stratford mbi Avon...**”.

Në këtë rast kemi përkthim fjalë për fjalë të toponimit por mungojnë vizat ndarëse. Në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” thuhet: “*Shkruhen me vizë lidhëse në mes emrat e përbërë gjeografik të huaj, edhe kur pjesët përbërëse lidhen midis tyre me një para-fjalë, lidhëz ose nyje*”.⁴

Në tekstin Letërsia 3 (profili shoqëror) për shkollën e mesme të përgjithshme, e botuar nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor mund të lexojmë në faqen 189:

“...**Uilliam Shekspir** lindi më 26 prill 1564 në **Angli**, në qytetin e vogël **Stratford – on Avon (Stratford mbi lumen Avon)**”.

Këto kohët e fundit emrat e disa autorëve të vjetër për drejtshkrimin e të cilëve tashmë është krijuar një traditë, në botimet e disa shtëpive botuese private vihet re thyerja e normës drejtshkrimore. Vlen për t’u përmendur këtu njëra prej veprave të shkrimtarit të njohur anglez Uilliam Shekspir, titulli i të cilit paraqitet me grafi të ndryshme.

Në tekstin Leximi Letrar për klasën e tetë të shkollës 9-vjeçare, në faqen 215 lexojmë: “**Uilliam Shekspir. Jul Qesari.**” (Kujtojmë se në librin e letërsisë për vitin e dytë të shkollës së mesme të përgjithshme emrin e autorit e gjejmë të shkruar **Uilliam Shekspir** me **ll**, e jo me **l**)

Në paragrafin 36, pika 11 të “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” thuhet:

“*Fjalët e huaja që burojnë nga greqishtja e vjetër, nga latinishtja apo nga gjuhët romane dhe që në këto gjuhë kanë një l të thjeshtë ose dyfishe, shkruhen me l dhe jo me ll*”.

Po kështu në botime të ndryshme gjejmë këto raste:

Libri i leximit të klasës së tetë për shkollat 9 – vjeçare, botim i vitit 2001 i Shtëpisë Botuese të Librit Shkollor, faqe 218.

“Pjesa është marrë nga tragjedia “**Jul Qesari**” e dramaturgut të njohur **Uilliam Shekspir**...”

⁴ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, § 68.

Antroponimet e huaja dhe problemet e përkthimit të tyre në gjuhën shqipe

Letërsia 3 për shkollën e mesme të profilizuar, profili shoqëror, botim i vitit 2003 nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, në faqen 190 veçojmë:

“...Uilliam Shekspir.....është periudha e tragjedive të mëdha.... Këtu Përmenden “Jul Qezari”....”

Në *Fjalorin Anglisht – Shqip* të Pavli Qesku, termin e të njëjtit personazh e gjejmë të përkthyer në shqipe me një ortografi tjetër, **Xhulius**⁵

Versioni anglisht është **Julius Caesar (xhuliës size)** dhe versioni italisht është **Jul Qezare (jul çezare)**.

Në librin “Historia e institucioneve” me autore Aurela Anastasi, për studentët e Fakultetit të Drejtësisë lexojmë:

*“... Deri në periudhën e Jul Çezarit këto shoqëri arritën të organizoheshin lirisht...”*⁶

Pra ky emër ka kaq shumë versione dhe mund të themi se norma e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe nuk është zbatuar drejt në asnjërin prej tyre. Në “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” thuhet:

*“Në pajtim me shqiptimin e sotëm letrar, fjalët me burim nga latinishtja a nga gjuhët romane, si dhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një c të ndjekur nga zanorja e ose i, shkruhen me c dhe jo me ç apo me s. Në pajtim me këtë rregull edhe emrat e përveçëm të kësaj kategorie shkruhen me c: Cezari, Lukreci...etj.”*⁷

5. Konkluzione

Të shkruarit e emrave të përveçëm të huaj sipas gjuhës origjinale nuk është një problem as i panjohur e as i padiskutuar më parë. Ky problem është shtruar për diskutim qysh në Kongresin e drejtshkrimit. dhe aty u vendos që edhe këta emra do të shkruheshin duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe, por sipas shqiptimit të tyre në gjuhën origjinale. Por sot, ndonëse nuk është në përputhje me rregullat e drejtshkrimit në fuqi, përditë e më shpesh, po lëshon shtat me shkrimet në gazeta, në revista dhe në librat që përkthehen nga gjuhët e huaja, të shkruarit e këtyre emrave sipas gjuhës prej nga merren. Madje, kjo ka marrë përmasa të atilla, sa që kanë filluar të lëkunden edhe disa prej gjuhëtarëve, studiues të mirënjohur të shqipes.

Të shkruarit sipas rregullave të shqipes është mënyra që e lehtëson mjaft punën, kur dihet se si shqiptohet një emër i huaj, sepse shqipja është gjuhë e pasur me fonema bashkëtingëllore të cilat plotësojnë pothuajse mjaftueshëm nevojat për shqiptim. Mirëpo kjo nuk do të thotë se gjithmonë kemi zgjidhje të qëlluar.”Megjithatë, zbatimi i parimit fonetik në këtë rast nuk jep gjithmonë përfundimet e pritura, sepse sipas tij shqiptimi i huazimeve bëhet më të shumtën e herës ose fare pak i përafërt ose i gabuar; dhe ky interpretim i pasaktë fiksohet në

⁵ P. Qesku, *Fjalori anglisht – shqip*, f. 94.

⁶ A. Anastasi, *Historia e institucioneve*, f. 107.

⁷ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, § 36 ë.

*një grafi jokorrekte që dhuron kërkesat e domosdoshme të drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit.*⁸

Këta vitet e fundit, krahas formave normative e në përputhje me rregullat e drejtshkrimit kanë filluar të shtohen rastet e thyerjeve të ndërgjegjshme të rregullave dhe, si pasojë, emrat e autorëve të ndryshëm të huaj, veprat e të cilëve përkthehen e botohen në gjuhën shqipe, po shkruhen sipas gjuhës prej nga merren duke u bërë shkak i thyerjeve të rënda të morfosintaksës shqipe.

BIBLIOGRAFI

- A. Dodi, *Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar*.
A. Hecer, *Shkrimi i emrave të përveçëm në gjuhën letrare shqipe*. Kon. Shken. '92.
A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj* 1973.
Drejtshkrimi i gjuhës shqipe 1973, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
Gramatikë e gjuhës shqipe, 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
Gj. Shkurtaj, *Drejtshqiptimi dhe norma letrare në skenë dhe në ekran*, K.Sh f. 301.
L. Dodbiba, *Rregullat e drejtshkrimit dhe përjashtimet*, K.D.
M. Çeliku, *Kongresi i Drejtshkrimit dhe norma gramatikore*, f. 77-84; 25 vjetori i K.të D.
M. Çeliku, *Shquarja e emrave të përveçëm në gjuhën shqipe*, SF, 1982/ 2.
M. Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*.
P. Daka, *Mbi drejtshkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve në gjuhën shqipe*, Kongresi i Drejtshkrimit, f. 235.
Rregullat e Pikësimit në gjuhën letrare shqipe (projekt), Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
Xh. Lloshi, *Facing the globalization; the case of the Albanian Language*. Studio Albanica.

Burimi i shembujve

- Letërsia 2 për shkollat e mesme të përgjithshme.*
Letërsia 3 për shkollat e mesme të përgjithshme.
Letërsia 4 për shkollat e mesme të përgjithshme.
Leximi letrar 7 për shkollën 8-vjeçare.
Leximi letrar 8 për shkollën 8-vjeçare.

⁸ Th. Shkurti, *Mbi drejtshkrimin e fjalëve të huazuara nga anglishtja*, Kong. i Drejt. f. 312.